



## **Rekrutimi dhe përzgjedhja e Ekipit të Nëpunësve për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura:**

Në përgjigje të njoftimit për shpalljen e pozicioneve të Nëpunësve për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura morëm mbi 400 email-e. Prej këtij numri, 381 përmbanin aplikime dhe nga këto, vetëm 282 përmbanin paketën e plotë të aplikimit, që do të thotë se aplikanti i kishte dorëzuar të gjitha materialet e kërkuara në njoftimin e shpallur.

32 kandidatë janë përzgjedhur për listën e shkurtër. Metodologjia për kalimin në këtë listë është, si vijon:

U shqyrtuan 282 aplikime të plota, për të kuptuar nëse ato ishin të mirëorganizuar dhe të detajuara, duke treguar një përpjekje aktive nga ana e kandidatit për t'iu përgjigjur siç duhet kërkesave të njoftimit dhe detajeve të punës;



209 prej tyre u klasifikuan për aftësinë e organizimit dhe vëmendjes të detajet. Ata u ekzaminuan më tej nëse zotëronin aftësi të mira me shkrim, të treguara në letrën e shprehjes së interesit, që iu ishte kërkuar të dorëzonin;



165 prej tyre e plotësonin kërkesën për t'u klasifikuar si kandidatë që kishin paraqitur një letër të mirë interesi, e cila ishte shkruar duke u përqendruar te hollësitë e lidhura me punën dhe tek informacioni i dhënë në njoftimin e punës. Më pas, ata u shqyrtuan nëse e plotësonin kërkesën për minimumin e 2 viteve të përvojës së punës;



139 prej tyre plotësonin kërkesën për minimalisht 2 vite përvojë pune të mëparshme dhe u shqyrtuan nëse kishin një Diplomë Masteri në Drejtësi;



130 e plotësonin kërkesën për Diplomën Master dhe u shqyrtuan për kalimin e Provimit të Avokatisë;



86 prej tyre e plotësonin kërkesën për Provimin e Avokatisë dhe u shqyrtuan për kriterin e totalit të viteve të eksperiencës. Mbështetur në thirrjen për aplikime, përshkrimin e punës të NUNÇP-ve dhe detyrave dhe përgjegjësi të pritshme, kandidatët e vlerësuar si të nënkualifikuar (më pak se 2 vite përvojë pune) dhe kandidatët e vlerësuar si të mbikualifikuar (6 ose më shumë vite përvojë pune) nuk u përzgjedhën për listën e shkurtër. U zbatua kriteri i 2 deri në më pak se 6 vite përvojë lidhur me fushën e punës, si kohëzgjatja optimale për këtë pozicion.



32 prej tyre e përmbushnin këtë kriter për kohëzgjatjen optimale të përvojës të lidhur me fushën e punës.



Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen për të kaluar në fazën e radhës së punësimit. Faza e radhës është zhvillimi i një provimi me shkrim.

Pas këtij provimi, përgjigjet do të vlerësohen kundrejt një rubrike pikëzimi dhe çdo kandidat që merr 60% të pikëve ose më shumë, kalon për në fazën e intervistës.

Intervistat do të vlerësohen sipas një liste të paracaktuar pyetjesh dhe një rubrike të detajuar pikëzimi. Një panel prej pesë personash do të vlerësojë individualisht çdo aplikant më vete dhe ato pikë do të mbliidhen për një total të kombinuar pikësh.

Ky total pikësh do të mbliidhet më pas me pikët që janë marrë nga provimi me shkrim për një vlerësim përfundimtar. Të gjithë aplikantët që marrin më shumë se 60% të totalit të pikëve të disponueshme, pra të kombinuar midis provimit me shkrim dhe intervistës, do të renditen sipas pikëve që marrin, nga më i larti te më i ulëti. Vendi i punës do t'i ofrohet aplikantëve që kanë marrë pikët më të larta.